



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 09.02.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Evgjëni Thaçi-Drăgusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Elmi Reçica, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Sërgjan Mitroviq.

Pjesëmarrësit e tjerë: Nita Latifi, Egnesa Vitia-praktikante dhe media.

Nga stafi i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 26 dhe 31 janar 2018;
3. Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i komisionit;
4. Diskutim lidhur me propozimet për emërimet e reja në Shërbimin diplomatik dhe respektimi i kuotës së paraparë me ligj;
5. Shqyrtimi i fushëveprimtarisë së Komisionit në draft- Rregulloren e Kuvendit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 26 dhe 31 janar 2018;

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhe 31 janar 2018.

3. Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i komisionit

Vjosa Osmani Sadriu tha se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është ndër aktivitetet themelore të Kuvendit dhe se është e nevojshme të formohen grupe punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimtaria e komisionit. Në kompetencë të komisionit tha se janë një sërë ligjesh, disa nga ato janë monitoruar në vitin 2012 e 2013, e disa nuk janë monitoruar fare. Ajo njoftoi për ligjet të cilat janë të nevojshme të monitorohen nga komisioni ynë, si nga fusha e punëve të jashtme, e po ashtu edhe nga fusha e diasporës dhe investimeve strategjike, si dhe për ligjet të cilat sipas strategjisë legjislative pritet t'i përcillen komisionit për shqyrtim. Propozoi që për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të formohen dy grupe punuese, njëri grup për monitorimin e ligjeve që janë brenda fushëveprimtarisë të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe grupi tjetër për monitorimin e Ligjit për Investime Strategjike dhe atë të diasporës e mërgatës.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në përbërje:

1. Aida Dërguti - kryesuese
2. Vjosa Osmani - anëtare
3. Time Kadrijaj - anëtare
4. Evgjëni Thaqi Dragusha - anëtare
5. Danush Ademi - anëtar

Zafir Berisha, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, propozoi që ato të mbikëqyren një nga një, pasi që mbikëqyrja e tre ligjeve në të njëjtën kohë është problematike. Ai tha se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve për shërbimin e jashtëm nuk është aspak e lehtë pasi që shërbimi i jashtëm është jashtë vendit dhe kjo paraqet vështirësi për monitorim, duke bërë të ditur përvojën në këtë drejtim nga legjislatura e kaluar.

Vjosa Osmani Sadriu theksoi se shërbimi i jashtëm sipas ligjit nuk përfshin vetëm diplomatët jashtë vendit, por përfshin gjithë stafin politik të MPJ-së. Në këto mbikëqyrje tha se duhet filluar me mbikëqyrjet brenda MPJ-së, pastaj duhet mbuluar edhe një numër të misioneve diplomatike që janë më esenciale dhe kanë strategji për zhvillimin e diplomacisë për Kosovën. Monitorimi i ligjeve tha se mund të ndahen duke filluar nga ato që janë më urgjente si Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ai për shërbimin diplomatik e më pas të mbikëqyret Ligji për Sanksionet Ndërkombëtare.

Time Kadrijaj propozoi që agjenda e takimeve për monitorimin e ligjeve të bëhet sa më shpejtë në mënyrë që pas përfundimit të punës dhe përgatitjes së raportit me rekomandime për seancë, të vazhdohet me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit tjetër.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën dhe Ligjit për Investimet Strategjike në përbërje:

1. Elmi Reçica ose Evgjëni Thaqi Dragusha - kryesues
2. Visar Ymeri - anëtar
3. Zafir Berisha - anëtar
4. Srgjan Mitroviq - anëtar
5. Doruntina Maloku Kastrati - anëtare

4. Diskutim lidhur me propozimet për emërimet e reja në Shërbimin diplomatik dhe respektimi i kuotës së paraparë me ligj

Vjosa Osmani Sadriu tha se ministri gjatë raportimit të tij në komision u pajtua që për momentin ka tejkalim të kuotës, së paraparë me ligj lidhur me emërimet politike dhe ato të karrierës, gjë për të cilën premtoi se do ta rregullojë. Përkundër premtimit të ministrit që të rregullohet kjo përqindje para se të dërgohen emërimet e reja, znj. Osmani Sadriu tha se në ndërkohë ka propozime nga MPJ. Ajo theksoi se ligji kërkon që ky proces të bëhet në besim dhe se nuk do të flasë për emra. Nëse komisioni pajtohet, tha se do të ia dërgoj një letër ministrit të punëve të jashtme për ta pyetur lidhur me balancimin e përqindjes së të emëruarve dhe pas këtij balancimi do të dëgjohen e kandidatët e propozuar. Znj. Osmani Sadriu tha se Kuvendi duhet ta mbikëqyrë respektimin e kësaj kuote dhe duhet të sigurohemi që ajo të respektohet.

Time Kadrijaj pyeti për përqindjen në mandatin e kaluar dhe theksoi se duhet t'i bëhet një analizë emërimeve të mandatit të kaluar dhe të shihet se a është respektuar kuota ligjore 50% me 50%.

Vjosa Osmani Sadriu theksoi se nuk ka informatë lidhur me përqindjen e kuotës ligjore në mandatin e kaluar, por ligji është shumë i qartë ku kuota ligjore është 50% me 50%, të cilën kuotë komisioni duhet ta respektojë. Ajo ritheksoi se ministri i Punëve të Jashtme në raportimin e tij para komisionit, ka njoftuar se mund ta rregullojë këtë çështje dhe pasi të rregullohet kjo, komisioni mund të fillojë me procedurën e dëgjimit të kandidatëve.

Zafir Berisha tha se ne asnjëherë nuk kemi mundur ta kuptojmë se cili është propozim i karrierës dhe cili është propozim politik. Ai njoftoi se në mandatin e kaluar në propozimet për ambasadorë ka pas njerëz meritore, por edhe propozime nga shoqëria civile. Kur po flasim për diplomatë të karrierës, tha se ne e dimë që jemi politikë e re në kuptimin e politikës së jashtme dhe është mirë që trupin diplomatik ta depolitizojmë. Kërkoj që të sqarohet se cili mund të jetë diplomat i karrierës dhe jo i karrierës.

Vjosa Osmani Sadriu duke iu referuar pyetjes së deputetit z. Berisha njoftoi se diplomatët e karrierës janë ambasadorët e parë dhe shërbyesit civilë që kanë hyrë në MPJ me konkurs dhe që i kanë kaluar të gjitha shkallët e gradimit nëpërmjet konkurseve, kurse diplomatët politikë janë gjithë të tjerët. Znj. Osmani-Sadriu tha se të gjithë të emëruarit në mandatin e kaluar janë politik, përveç ata që kanë qenë pjesë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës. Ligji kërkon që 50% i parë të jenë emërimet politike, kurse 50% tjetër është me rotacion.

Dukagjin Gorani pyeti se a është roli i komisionit në analizimin e cilësisë së shërbimit diplomatik, apo është vetëm në monitorimin e zbatimit formal të përqindjes, pavarësisht cilësisë. Ai tha se do të ishte më me interes nëse komisioni është në gjendje të analizojë dhe të kontribuojë në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit diplomatik pavarësisht kuotës. Z. Gorani tha se ne jemi përfaqësues të Kuvendit dhe duhet të merremi më shumë me cilësi sesa me një formë të inspektoratit të punës.

Vjosa Osmani Sadriu njoftoi se zbatimi i Ligjit për Shërbimin e Jashtëm në mënyrë specifike kërkon nga ne që ta monitorojmë edhe cilësinë, pra ta vlerësojmë se sa po e kryejnë punën e vet në aspektin profesional edhe në përputhje me ligjin të punësuarit në ambasadat tona.

Visar Ymeri tha se ne, si komision, do të duhet të përqendrohemi në cilësinë e përfaqësimit tonë diplomatik dhe se ideja e nenit 6 të këtij ligji, është e shtrirë në shumë ligje që kanë të bëjnë me emërimet. Ai shprehu mendimin se duhet të synohet zbatimi i këtij neni, sepse cilësia do të nxirret, duke i inkurajuar njerëzit që nuk janë pjesë e partive politike për të konkurruar në poste të caktuara.

5. Shqyrtimi i fushëveprimtarisë së komisionit në draft- Rregulloren e Kuvendit

Vjosa Osmani Sadriu njoftoi se është duke u punuar në Rregulloren e Kuvendit dhe se ka kërkuar nga grupi punues i Komisioni për Legjislacion që t'i drejtohet secilit komision dhe të kërkojë nga ta komente lidhur me kompetencat e tyre. Ajo kërkoi nga anëtarët e komisionit që të dërgojnë propozime dhe komente lidhur me fushëveprimin e komisionit tonë.

Visar Ymeri kërkoi nga stafi i komisionit të paraqesin propozimet dhe komentet e tyre për shkak të përvojës së tyre në punën e komisionit, e po ashtu kërkoi komente edhe nga organizatat jo qeveritare që e mbikëqyrin punën e komisionit.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Stafi mbështetës i komisionit së bashku me organizatat që e monitorojnë punën e komisionit të përgatisin propozime konkrete lidhur me fushëveprimin e komisionit.

6. Të ndryshme

Vjosa Osmani Sadriu, njoftoi se më 20 shkurt 2018 është ftuar z. Avni Arifi, shef i negociatave me Serbinë që të raportojë lidhur me platformën e Qeverisë së Kosovës për procesin e dialogut Kosovë-Serbi, kurse më 27 shkurt 2018 është ftuar z. Flamur Sefaj, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të raportojë lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol. Znj. Osmani, po ashtu, njoftoi se Komisioni për Punë të Jashtme udhëheq një proces të koordinimit me komisionet e tjera lidhur me monitorimin e dialogut, ku marrin pjesë kryetarët e komisioneve. Ajo tha se ky është një organizim i përbashkët me KDI-në, të cilët do ta propozojnë një draft-rezolutë e cila do t'i përcaktojë vijat e kuqe të dialogut.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu